



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 258/Prot.
10

Pogradec, më 26.01. 2024

VENDIM

Nr. 5 datë 25.01, 2024

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE, Z.MIRJAN BUZO PËR DËMET E SHKAKTUARA NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESË

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, të pikës 1 të nenit 29, të ligjit nr. 139/2015, “Për Veteqeverisjen Vendore”, të neneve 4, 7 dhe 41, të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe të kapitullit III të V.K.M nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e kërkesës së Bashkisë Pogradec për mbështetje financiare të shtetasit Mirjan Buzo, për dëmtimin e banesës nga rënia e zjarrit në datën 22.12.2023
2. Miratimin e dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Pogradec.
3. Ti akordojë familjes së shtetasit Mirjan Buzo, ndihmën emergjente në vlerën prej **205 109.7LEK** nga buxheti i Bashkisë Pogradec, fondi i emergjencave civile i destinuar dhe miratuar nga Këshilli i Bashkisë Pogradec për vitin 2023.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Emergjencave Civile, Strehimi dhe Administrimit të Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative, si dhe Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare të Bashkisë Pogradec.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes:

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

